



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës



Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority

Nr.01/19

Datë: 15.02.2019

Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës në mbështetje të nenit 28, 29, 35, 36, 37,38 dhe 54, të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës Nr. 03/L-229 (Gazeta zyrtare Nr. 88/25), dhe Ligji Nr. 04/L-226 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, si dhe Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme, sipas detyres zyrtare pas shqyrtimit të raportit paraprak në tregun e derivateve të naftës mbi dyshime për marrëveshje të ndaluar dhe abuzim me pozitën dominuese të ndërmarrjeve që importojnë e shesin derivate të naftës me shumicë dhe pakicë në tregun relevant, nxjerr këtë:

KONKLUZION

I. Për fillimin e procedurës hetimore për shkak të dyshimeve të bazuara për ç'rregullim të konkurrencës në tregun e derivateve të naftës në kundërshtim me nenin 4 "Marrëveshje të ndaluar" dhe nenin 11 "Abuzim me pozitën dominuese", ndaj këtyre ndërmarrjeve:

1. **HIB PETROL Shpk** Nr. Fiskal: 600015376, adresa: Talinoc i Muhaxherëve - Komuna e Ferizajt.
2. **AL - PETROL Shpk** Nr. Fiskal: 600029848, adresa: Vragoli – Komuna e Fushë Kosovës.
3. **EX FIS Shpk** Nr. Fiskal: 600090328, adresa: Sheshi Bill Clinton, Komuna e Prishtinës.
4. **LAB - OIL Shpk** Nr. Fiskal: 600213722, adresa: Preoc, Magjistralja Prishtinë - Shkup, Komuna e Graçanicës.
5. **IP - KOS Shpk** Nr. Fiskal: 601054448, adresa: Rr. Elez Berisha Nr. 20, Komuna e Prishtinës.
6. **PETROL COMPANY Shpk** Nr. Fiskal: 600118120, adresa: Magjistralja Prishtinë - Fushë Kosovë, Komuna e Prishtinës.
7. **ALBA PETROL GROUP Shpk** Nr. Fiskal: 601736624, adresa: Rr. Rexhep Bislimi Pn, Komuna e Vitisë.
8. **ALFA TRADE Shpk** Nr. Fiskal: 600224050, adresa: Klinë e Poshtme, Komuna e Skenderajt.
9. **KASTRATI - GROUP Shpk** Nr. Fiskal: 601634323, adresa: Jagnela, Komuna e Prishtinës.
10. **PATRONI Shpk** Nr. Fiskal: 601543186, adresa: Miradi e Ulët, Komuna e Fushë Kosovës.
11. **BENITA COMPANY Shpk** Nr. Fiskal: 600233308, adresa: Gremnik, Komuna e Klinës.
12. **N.P.T IBRAHIMI** Nr. Fiskal: 600052469, adresa: Muzeqinë, Komuna e Shtimes.
13. **BLU OIL Shpk** Nr. regjistrimit: 810133041, adresë: Drenoc, Komuna e Malishevës.
14. **PETROL OTI SLOVENIJA L.L.C** Nr. Fiskal: 600112370, adresa: Magjistralja, Prishtinë – Mitrovicë, Komuna e Prishtinës.
15. **VEDA -2 PETROLL Shpk** Nr. Fiskal: 600215538, adresa: Rr. 4 Korriku, Komuna e Vitisë.
16. **N.P.T. FAT OIL Shpk** Nr. Fiskal: 600898623, adresa: Magjistralja Prizren – Gjakovë, Xërxë, Komuna e Rahovecit.

- II.** Autoriteti Kosovar i Konkurrencës kërkon nga ndërmarrjet e lartcekura si në diapozitivin (I) të këtij konkluzioni që në afat prej **30 (tridhjet) ditësh** t'i sjellin në zyrat e Autoritetit këto dokumente:
- a) Librin e blerjes nga 01.01.2018 deri më 31.12.2018, *(fizike dhe në form elektronike)*
 - b) Librin e shitjeve nga 01.01.2018 deri më 31.12.2018, *(fizike dhe në form elektronike)*
 - c) Kontratat dhe aneks kontratat e tenderëve të fituar prej 01.01.2018 deri më 31.12.2018
 - d) Marrëveshjet/Kontratat e bashkëpunimit me kompanitë tjera në shitblerjen e derivateve të naftës
 - e) Çmimin ditor (Blerës dhe Shitës) të naftës dhe benzinës për periudhën 01.01.2018 deri më 31.12.2018. *(fizike dhe në form elektronike)*
 - f) Të dhënat tjera të kërkuara nga hetuesit e AKK-së.
- III.** Mos ofrimi i të dhënave të kërkuara apo ofrimi i të dhënave të rrejshme për Autoritetin si në dizpozitivin (II) të këtij konkluzioni, ndërmarrjet në procedurë ndëshkohen deri në 2% (dy) përqind të totalit të të hyrave që ndërmarrja e ka realizuar në vitin e fundit, për të cilin është përfunduar raporti financiar.
- IV.** Ky konkluzion hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Komisionit.

A R S Y E T I M

Bazuar në shqetësimet e ngritura nga opinionin publik, përmes mediave dhe shoqëria civile rreth pretendimeve të tyre për marrëveshje të ndaluar apo praktikë të bashkërenduar në mes të ndërmarrjeve të cilat merren me tregtimin me derivate të naftës në shitjen me shumicë dhe pakicë të naftës dhe benzinës në territorin e Republikës së Kosovës, Komisioni i AKK-së në mbledhjen e mbajtur me datë 24.12.2018, ka vendosur për monitorimin në tregun e sektorit të naftës (nënprodukti: Eurodiesel dhe Benzinë).

I. Tregu përkatës apo relevant

Tregu përkatës është përcaktuar në nenin 3 paragrafi 1.8 të Ligjit dhe nenin 6 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ për mënyrën e përcaktimit të tregut relevant Nr. 02/2018.

Përkufizimi i tregut përkatës përfshin dy dimensione:

Tregun e produkteve dhe

Tregun gjeografik

Tregu gjeografik - Duke iu referuar nenit 6 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ për mënyrën e përcaktimit të tregut relevant Nr. 02/2018 ndërmarrjet nën monitorim që zhvillojnë veprimtarinë e tyre në tregtimin me derivate të naftës në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës, pra treg përkatës gjeografik do të konsiderohet tregu i brendshëm i Republikës së Kosovës.

Tregu i produktit është: Sektori i naftës - biznesi me derivate të naftës në Kosovë.

Tregu përkatës i produktit përfshin tregun e importit dhe shitjes me shumicë dhe pakicë në sektorin e naftës dhe derivateve të naftës, për dy nëntregjet:

- nëntregu i produktit Naftë dhe

- nëntregu i produktit benzinë.

II. Përshkrimi i rastit:

Gjatë monitorimit në tregun përkatës në sektorin e naftës lidhur me rastin, takimeve të zhvilluara me palët të cilët merren me importin, blerjen dhe shitjen e derivateve të naftës me shumicë dhe pakicë, analizimit dhe vlerësimit të të dhënave të grumbulluara gjatë monitorimit, dokumentacioni i siguruar nga Dogana e Kosovës, Administrata Tatimore e Kosovës, MTI, MF, si dhe konsultimit me rregullativën ligjore që i rregullon këto çështje Autoriteti Kosovar i Konkurrencës ka nxjerrë strukturën e tregut të ndërmarrjeve të cilat tregtojnë dhe importojnë derivate të naftës me shumicë dhe pakicë, për ndërmarrjet të cilat kanë ndikim të ndjeshëm në sektorin e tregut të naftës.

Përkitazi me këtë, Komisioni i AKK-së ka vendosur të fillojë procedurën e thelluar hetimore në tregun përkatës për të vërtetuar pretendimin mbi dyshimet nëse ka marrëveshje, koordinim, praktikë të bashkërenduar apo sjellje paralele në treg për fiksimin e çmimeve të naftës dhe benzinës ndërmjet ndërmarrjeve që janë objekt hetimi për këtë rast.

Autoriteti në procesin e monitorimit në sektorin e naftës në Republikën e Kosovës ka vërejtur se ka mos reflektim të uljes së çmimit të naftës dhe derivateve të naftës kur ka lëvizje të çmimit, ulje apo ngritje, të këtij produkti në berëza.

- III. Periudha e hetimit për ndërmarrjet e përcaktuar në diapozitivin (I) të këtij konkluzioni është nga: 01.01.2018 deri më 31.12.2018

Këshilla Juridike: Kundër këtij konkluzioni për fillimin e procedurës së thelluar hetimore nuk është e lejuar ankesa e as padia për inicimin e konfliktit administrativ.

AUTORITETI KOSOVAR I KONKURRENCËS KOMISIONI

(_____)
Valon PRESTRESHI
Kryetar

(_____)
Ahmet KRASNIQI
Zv. Kryetar

(_____)
Fatime HAZIRI
Anëtare

(_____)
Muhamed KRASNIQI
Anëtarë

(_____)
Shaqir MORINA
Anëtarë

Me këtë **KONKLUZION** të njoftohen:

- *Arhiva*
- *Ndërmarrjet*
- *WebFaqen e AKK-së*